

**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E  
RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS  
PER AKTIVITETIN**

**Prerja, gdhendja dhe lustrimi i gurit**



**Subjekti :NDERTIMI KRISTIANshpk**

**Vendodhja e ushtrimit te aktivitetit: Nikel, Kruje, Durres**

**Kruje 2021**

## HYRJE

Raporti synon te jape nje informacion te detajuar dhe te besueshem lidhur me ndikimin mjedisor te projektit te propozuar ne perdorimin e tokes, efektet lidhur me ndikimet ne floren, faunen, burimet e ujit, shkarkimet ne toke, uje, si dhe çdo ndikim social ekonomik ne punesimin lokal, permiresimin e infrastruktures dhe ndikimeve te tjera te rendesishme mjedisore ose sociale, perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permisimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet :

- Marrjes ne konsiderate te çeshtjeve te mjedisit ne fazen e pergatitjes se projektit.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit te aktivitetit mbi mjedisin human.
- Analizen e faktoreve pozitive e negative mjedisore, percaktimin e masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimin cilesor te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne projekt.

Per kete problem u be mbikqyrja e terrenit ne te gjithë zonen, duke kryer vrojtime te ndryshme , si dhe te biodiversitetit.

Ne raport jepet statusi i territorit, korniza ligjore e tij, mjedisi biofizik, gjeologjia e rajonit, gjeologjia e zones, hidrogjeologjia.

Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk eshte i rendesishem vetem per njerezit por eshte thelbesor dhe i nevojshem per te gjitha qeniet ne toke. Njerezit duhet te kuptojne se si perdorimi i burimeve mjedisore dhe perfitimet qe vijne nga ato te mos demtohen por te jete e mundur te perfitohet sot dhe ne te ardhmen.

Termi mjedis dhe burime natyrore perdoren shpesh por jo gjithmone me kuptimin e qarte qe i perkufizon . Burimet natyrore i referohen burimeve te tokes, ujerave siperfaqesore dhe nentokesore , ajrit qe rrethon token, çdo gje qe rritet ne toke apo det si dhe burimet qe gjenden nentoke si psh mineralet. Mjedisi eshte me gjithperfshires, cdo gje qe na rrethon.

Thjesht duke perdorur burimet natyrore ne rrezikojme ne mbiperdorimin dhe shterimin e tyre . Shterimi i burimeve natyrore eshte nje nga problemet thelbesor te çrregullimit te mjedisit. Ne te perfshihet shterimi i ujit, mineraleve perfshire dhe lendet fosile si dhe shume burime te tjera.

Çdo veprimtari e kryer nga njeriu shoqerohet edhe me impakt ne mjedis. Pra impakti mjedisor i referohet ndryshimit te mjedisit natyror nga aktiviteti njerezor.

Kemi dy tipe te impaktit mjedisor

- Shterimi i burimeve
- Ndotja

Ne menyre qe te shmangen keto probleme njerezimi duhet te mesoj se si te menaxhohen burimet natyrore ne menyre te qendrueshme. Pra zhvillimi i qendrueshem i burimeve natyrore nuk eshte gje tjeter vecse perdorimi i tyre ne menyre ekonomike nga brezat e sotem per ti len keto burime te perdoren edhe nga brezat qe do te vijne.

Qendrueshmeria perfshin menaxhimin e gjithe perberesve dhe burimeve natyrore e njerezore me qellim qe te pasurohen me kalimin e kohes dhe te sigurohet nje mireqenie per te gjithe. Zhvillimi i qendrueshem nuk i pranon politikat te cilat cojne ne uljen e bazes prodhuese dhe lene gjeneratat e ardhshme me prespektiva me te ulta ( te varfera) dhe/ose rreziqe me te medha se te tonat. Teknologjite qe kontribuojne ne zhvillimin e qendrueshem perfshijne kontrollin e ndotjes, prodhimin e energjise se riciklueshme, rikuperim burimesh dhe riciklim, menaxhim burimesh dhe kerkime shkencore.

Problemet mjedisore ne vendin tone lidhen me ndotjen e ajrit ne qytetet kryesore , ndotja e ujit e cila vjen nga shkarkimi i ujerave te ndotura pa u trajtuar fillimisht dhe mbetjet urbane te cilat jo te gjitha depozitohen ne vendet e caktuara.

## **INFORMACION PER QELLIMIN E VNM DHE METODIKEN E ZBATUAR**

### **Pershkrim te qellimit dhe objektivave te VNM**

Vleresimi i ndikimit ne mjedis eshte nje proces ne vazhdimesi i aktivitetit dhe siguron se ndikimet mjedisore te rendesishme, sinjifikante jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim, zbatim te aktivitetit qe do te zhvillohet.

### **Qellimi i VNM- se**

Qellimi i hartimit te raportit te VNM-se eshte percaktimi i efekteve negative dhe pozitive te aktivitetit dhe masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis si rezultat i zhvillimit te **aktivitetit te prerjes , gdhenjes dhe lustrimit te gurit.**

VNM nuk do te mbuloj cdo aspekt te nje efekti mjedisor te projektit, me te njejtin nivel detajesh. Theksi do te vihet ne ndikimet kryesore qe shkakton zhvillimi i aktivitetit.

Gjithashtu nje synim tjeter eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike- organizative per zbutjen e aneve negative qe mund te krijohen gjate zvillimit te aktivitetit dhe te jape informacion per vendim-marresit per pasojat mjedisore te aktiviteve te propozuara.

VNM perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet :

-Marrjes ne konsiderate te ndikimeve te mjedisit qe ne fazen e pergatitjes se propozimeve ne projekt.

-Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.

-Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit ne mjedis te aktivitetit mbi mjedisin human.

-Analizes se faktoreve pozitive e negative mjedisore dhe te masave zbutese per reduktimin

e ndikimeve negative.

-Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimi cilesor me pika te ndikimeve ne mjedis te projektit.

-Propozime te masave zbutese te ndikimit ne mjedis te projektit.

### **Objektivat e VNM**

Objektivat e hartimit te VNM- se konsistojne ne evidentimin dhe reduktimin e ndikimeve ne mjedis dhe masat tekniko-organizative per nje zhvillim te qendrueshem te mjedisit, gjate kryerjes se aktivitetit deri ne perfundim te tij dhe rehabilitimin e hapesires perreth objektit.

Me kete studim informojme organet vendim-marres, mbi ndikimet ne mjedis dhe perfitimet e projektit te propozuar. Gjithashtu zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe zbatimi i projektit nuk prek burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose veprimtari.

### **Objektivat e tjera te studimit te paraqitur jane.**

- Permiresimet mjedisore te zones ku zbatohet projekti dhe rreth saj.
- Perdorimin e burimeve natyrore ne menyren te qendrueshme ku respektohen dhe kerkesat e komunitetit te zones per rreth.
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale negative te projektit te zbatuar
- Lehteson informimin e organeve vendim-marrese, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.
- Mbrojtjen e shendetit te njeriut.
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit.
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peziashet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve.
- Permireson aspektet sociale te projektit.

### **Pershkrim i metodikes te zbatuar per hartimin e raportit te VNM**

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis hartohet me kerkese te shoqerise **per aktivitetin e prerjes, gdhendjes dhe lustrimit te gurit.**

Studimi i vleresimit te ndikimit ne mjedis u orientua nga rendesia dhe madhesia e projektit, vendi ku ai do te zhvillohet , pasurite natyrore dhe humane te zones si dhe vlerat e vecanta te tyre ne identifikimin e ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutese duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike te investitorit dhe masat orientuese pas mbylljes se projektit.

Reduktimi i ndikimeve negative eshte nderthurur edhe me ndikime te rendesishme pozitive sidomos ne perfitime direkte dhe indirekte mbi komunitetin.

### **Studimi strukturohet ne kater faza kryesore :**

- 1.Ngritja e objektivave orientuese te V.N.M.
- 2.Mbledhja e materialit baze ekzistues dhe atij te formuluar enkas per kete projekt dhe seleksionimi i tyre per perdorim.
- 3.Verifikimi ne terren i te dhenave ekzistuese dhe mbledhja e te dhenave te mundeshme biofizike dhe humane.
- 4.Hartimi i projektit bazuar ne legjislacionin Shqiptar si dhe kerkesave te organeve vendim-marrese dhe kontrollues te objekteve mjedisore ne nivel kombetar dhe lokal.

### **PERSHKRIM I PROJEKTIT TE PROPOZUAR**

**Shoqeria NDERTIMI KRISTIAN shp** eshte regjistruar prane QKB –se me nr. NIPT J67902332G, adresa qendrore eshte Zona Kadastrale nr.3096, me pasuri nr.97/18, Qereke, Nikel, Kruje, Durres dhe administrator Drane Malçi, objekti aktivitetit Prodhimi dhe perpunim i materialeve te ndertimit ,karriere blloqe mermeresh,mermere granite dhe gure dekorative,ndertime,projekte dhe shit blerja e materialeve te ndertimit,brenda ose jashte vendit.

#### **Qellimi i projektit te propozuar**

Qellimi I aktivitetit eshte prerja, gdhendja dhe lustrimi I gurit te cilat perdoren ne industrine e ndertimit. Sheshi ku zhvillohet ky aktivitet është i sistemuar, aktiviteti zhvillohet brenda siperfaqes se miratuar nga shoqeria. Brenda kesaj siperfaqe eshte instaluar Impianti per prerje, gdhendje dhe lustrim guri, gjithashtu dhe sheshi per depozitimin e materialeve.Objekti disponon hapesirat e nevojshme per zhvillimin e proceseve teknologjike per prerje, gdhendje dhe lustrim guri, ku eshte instaluar dhe impianti me makinerite dhe pajisjet e domosdoshme.

**Qëllimi i këtij aktiviteti është të realizoje prerje, gdhendje dhe lustrim guri.**

#### **Të dhëna mbi impiantet e instaluar**

Shoqëria “ **NDERTIMI KRISTIAN** ” shpk si firmë me aktivitet në fushën e veprimtarisë së prerjes, gdhendjes dhe lustrim guri, ka investuar dhe disponon impiantet/makineritë e domosdoshme për zhvillim e proceseve kryesore në prodhimin e produktit përfundimtar.

#### **IMPIANTI I PRERJES, GDHENDJES DHE LUSTRIM GURI**

##### **Të dhëna mbi impiantin e instaluar**

Shoqëria “**NDERTIMI KRISTIAN** ” shpk si firmë me aktivitet në fushën e veprimtarisë së prerjes, gdhendjes dhe lustrim guri, ka investuar dhe disponon impiantet/makineritë e domosdoshme për zhvillim e proceseve kryesore në prodhimin e produktit përfundimtar.

## •Instalimet/Pajisjet e impiantit per prerje, gdhendje dhe lustrim guri

- oThyeresi i gureve
- o Thika e prerjes me uje
- o Transportuesi
- o Makineri per lucidim
- o Pajisja e gdhendjes se gurit apo mermerit

### **Pershkrim i pergjithshem**

Impianti i prerjes, gdhendjes dhe lustrim guri funksionon mbi bazen e nje procesi te thjeshte fizik, i cili ben te mundur qe lenda e pare qe ka permasa te medha, i nenshtrohet proceseve fizike ne linjen e prerjes, gdhendjes dhe lustrim guri, duke perftuar ne kete menyre produktin e deshiruar. Ne kete godine realizohet punime te mermerit dhe gureve te tjere dekorative. Si lende e pare per kete proces do te perdoren pllaka mermeri dhe gure dekorative dhe magazinohet ne ambjentet e jashtme te godines pas prejes, perpunimit dhe lustrimit. Prosesi i realizimit te ketij produkti eshte i thjeshte: merren pllakat e mermerit dhe gureve dekorative dhe priten ne baze te porosive te ndryshme qe merren. Prerja e pllakave te mermerit behet me sharre me uje, ku pritet me permasa fikse. I gjithë ky process kryhet me uje qe nuk lejon ngritjen e pluhurave. Pastaj mermeri i prere apo guri dekorativ kalon perlustrim dhe lucidim, i gjithë ky proces kryhet me uje qe nuk lejon ngritjen e pluhurave.

Ujerat teknologjike terhiqen perseri me ane te nje pompe zhytесе pasi kalojne ne vasken e dekantimit, prabehet dhe nje riciklim te ujit teknologjik. Ambjentet e subjektit jane te mire ajrosura. Copat emermerit qe dalin gjate punes, nuk hidhen, por riperdoren per tu bere mozaik.

Për përpunimin e gurëve dekorativ përdoren makineri prerëse me disk diamanti, përpunimi me buratotriçe, prerje kubikesh me tranxha, gdhendje pllakash me çekiç gdhendes elektrik dhe përpunimi me dorë, ne menyre artizanale. Puntorët fillimish kryejnë ndarjen e blloqe ne lastra më të vogla me trashësi sipas kërkesave të tregut duke filluar nga trashësia 5 mm deri në trashësinë 300 mm. Sipas kërkesave këto pllaka afrohen tek makinerite si: Tranxhë, Sharat prerëse të cilat në këtë impiant janë dy, Buratotriçe ose tek puntorët qe do te kryejne perpunimin si gdhendje dhe skalitje. Në sharat prerëse kryhet prerja e pllakave në madhesinë dhe formën që i kërkon tregu ose është kryerporosia nga klienti që kërkon ti blejë.

Tranxha kryen prerjet e pllakave në formë kubike dhe drejtëkëndshi në madhesinë dhe formën që i kërkon tregu ose është kryer porosia nga klienti që kërkon t'i blejë. Buratotriça kryen larjen e t'ë gjitha prodhimeve që janë përgatitur për t'u tregtuar duke u dhënë formë sa më afër me atë natyrale. Puntorët kryejnë gdhëndje, skalitje dhe vendosjen në baleta të produktit përfundimtar. Prodhimi në baletat mbështillet me plastmas ose me rretë telí dhe ne kete forme eshte i gatshem per tu tregtuar ne tregun vendas ose ne eksport. Makineritë prerëse janë të lidhura me këtë depozitë me ndihmën e tubacioneve hidraulike.

Subjekti punon mbi bazen e porosive individuale te klienteles. Ben te gjitha llojet e prerjeve dhe formave, prerje ne gjatesi, prerje ne trashesi, jepen format e zmusuara ose te rrumbullakosura etj. Formatet masive te mermerit, pllakat e mermerit, te granitive, me dimesione te medha (2.5x1.5m, 2x2m etj. ) dhe me trashesi te caktuar si dhe gurit dekorative me permasa dhe forme te crregullt. Sillen ne objekt me automjete perkatese dhe depozitohen ne sheshin perkates duke u vendosur kryesisht ne kernbe nepermjet konstruksioneve te pershtateshme metalike. Ketu, shkarkohen me Vinc dhe mandej levizen me mjete te tjera ngritese dhe vendosen mbi bangon e prerjes te sharrave diskore.

Disqet prerese, te cilet jane te perbere sipas shkalles se fortesise me aliazhe dhe lidhjes metalike shume te forta, vihet ne levizje me ane te elektromotoreve. Gjate procesit te prerjeve krijohen pluhura mermeri, te cilat menjehere lagen, per te mos lejuar daljen e tyre ne mjedisin e punes. Per kete qellim ne zonen e prerjes hidhet uji, i cili sherben ne te njejten kohe edhe per ftohjen e tehut prerese te diskut te prerjes.

Uji, me pluhurat e tretur ne te, derdhet ne siperfaqen e pllakes se mermerit dhe te bangos se prerjes dhe nepermjet tyre derdhet mbi sheshin e prerjes ,kanalet e brendshme e percjellin ne gropen e dekantimit te llumrave te mermerit. Gropa eshte e ndare ne seksione. Llumrat e pluhrave te mermerit dekantojne ne te dhe, ne seksionin e fundit, nje pompe centrifugale e qarkullon ujin e paster ne sharren e prerjes. Sipas gjendjes se nivelit te ujit ne gropen e dekantimit, atje shtohet nje sasi e re uji, ose shkarkohet uji i tepert me veterrjedhje. Ky uji eshte normalisht i paster dhe pa permbajtje te demshme pervec prezences se mbejteve nga procesi i prerjes dhe llumrave me perberje kalcite.

Llumrat e mermerit, te dekantuar, tashme ne formen e nje llumi depozitohen ne nje vend te caktuar per te dhene ne perdorim pas tharjes nga subjekte te cilat prodhojne lende te ndertimit te cilat keto mbetje te ngurta perdoren si aditive. Ate pelqehen me shume per suvatime te ndryshme si dhe ne punime dekorative. Mbas prerje se formative te medhenje ne fleta ose pllaka mermeri me permasa relativisht te medha kalojne ne makinerite e lucidimit te cilat do te marrin shkelqimin e kerkuar dhe paraqitjen dekorative.


Mbas prerjes se copave ne permasat e caktuara dhe te kerkuara, ate vendosen mbi nje bango tjeter ku ju behet rrumbullakosja e buzeve te prerjes ose dhe ndonje punim tjeter i thjeshte, qe eshte kerkuar nga klientela. Per kete qellim perdoret guret zmerilo zmusuese. Gjate ketij procesi krijohen gjithashtu pluhurat e mermerit, te cilat edhe pse ne sasira te vogla, dalin direkt ne mjedisin e punes, ku punonjesit jane pajisur me mjetet e nevojshme te punes si maske, doreza, syze, tapa per veshet, kominoshe, kepuce me maje metalike etj. Punonjesit qe punojne jane te paisur detyrimisht me maska antipluhur.

## Produktet kryesore te impiantit te përpunimit, prerjes dhe lustrimit te mermerit dhe gurëve dekorative

Kompania "NDERTIMI KRISTIAN" sh.p.k ne linjen e vet te prerjes, gdhendjes dhe lustrim guri prodhonprodukte te ndryshme. Secili nga produktet ka perberje cilesore te ndryshme, ne varesi te trajtimitfizik qe i eshte nenshtuar lenda e pare ne impiantin e fraksionimit, produktet e perftuara janeprodukte te perpunuara te:

- Mermerit
- Graniteve
- Kuartezit dhe te ngjajshme me to

Uji qe perdoret per eliminimin e pluhurit gjate procesit te prerjes riqarkullon ne proces me ane te nje pompe pasi kalon ne vaskene dekantimit .Subjekti perdor dhe ujerat e ardhura nga reshjet.



- **Pershkrim i mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar dhe me fotografi**

Per nga origjina , perberja dhe vecorite gjeobotanike bimesia e Shqiperise ben pjese ne nenazonen floristike mesdhetare e cila perfshihet ne nje njesi me te madhe, ne zonen holarktike. Ndikim te madh ne zhvillimin e flores mesdhetare ushtroi ftohja e pergjithshme e klimes ne periudhen e pleistocenit dhe akullzimi i fuqishem qe pasoi ate. Tiparet karakteristike te bimesise mesdhetare si per sa i perket



vecorive gjeobotanike ashtu edhe perberjes morfologjike dhe shtrirjes vertikale te saj, jane karakteristike edhe per bimesine e vendit tone.

E gjithë kjo pasuri floristike i detyrohet vecorive te evolucionit paleogeografik te Shqiperise dhe sidomos larmise se madhe te klimes, copetimit te theksuar te relievit dhe formave te shumellojshme te tij, formacioneve te shumta shkembore ( gelqerore, magmatike, terrigjene) etj.

Fitocenozat e bimesise barishtore shume te larmishme nga perberja e llojeve, gjenden ne te gjitha zonat fitoklimatike te Shqiperise. Megjithese fitocenozat barishtore nga ana e fizionomise ne pergjithesi duken relativisht te peraferta, ato ndryshojne midis tyre nga perberja floristike ne varesi te faktoreve ekologjike. Me perjashtime te pakta, gati ne te gjitha fitocenozat dhe bashkeshoqerimet barishtore gjenden perfaqesues te familjes graminore ( Graminaceae).

Bimet qe rriten ne zonen ku do te shfrytezohet nuk gezojne status te vecante te ruajtjes kombetare dhe nderkombetare te tyre.

- **Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme negative ne mjedis te projektit perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer**

#### **Shkarkime ne uje**

Ne procese teknologjike te impiantit te perpunimit te gurit dekorativ do te perdoret uji. Te gjitha makinerite e montuara ne kete impiant me perjashtim te tranxhes e kane domozdoshmeri perdorimin e ujit. Uji njekoheisht do perdoret per lagien e territorit per paksimin e pluhurave.

Ujrat e ndotura nga procesi teknologjik dhe nga pluhurat e krijuara do te depozitohen ne vaskat e ndertuara ne sheshin e impiantit.

#### **Emetime ne ajer**

Emisione gazesh gjate aktivitetit do te kemi ne disa veprimtari. - Perdorimi i gjeneratorit ne rastet kur nderpritet energjia elektrike - Mjetet e transportit qe sjellin lenden e pare transportojne produktin perfundimtare, mjetet e punonjesve dhe vizitoreve. Mundesia e shkarkimit te pluhurave eshte gjate levizjes se automjeteve sepse gjate procesit te prerjes duke qen se kemi perdorim te ujit nuk gjenerohen pluhura.

#### **Ndikimi ne toke**

Keto procese pune ne kete aktivitet nuk ndikojne aspak ne toke, procesi teknologjik i prerjes dhe gdhenjes se gurit dekorativ nuk gjeneron mbetje te cilat shkaktojne ndotje te tokes. Copat e gurit dekorativ qe dalin nga procesi i prerjes perdoren per mozaik.

#### **Ndikimi ne biodiversitet**

Sipas verifikimeve te kryera lloji i aktivitetit nuk ndikon ne biodiversitet. Flora dhe fauna e zones nuk do te ndikohet nga aktiviteti i shoqerise.

### **Zhurmat dhe vibrimet**

Zhurmat do të shkaktohen nga pajisjet e instaluar sharrat, tranxhat etj si dhe nga makinat e transportit të lëndës së parë dhe produktit përfundimtar..

### **Ndikime socio-ekonomike**

Nuk parashikohen të shkaktohen ndikime negative nga zhvillimi i projekteve të tilla në pjesën sociale ekonomike, për arsye se këto projekte ndihmojnë në rritjen e punesimit.

- **Nje pershkrim per shkarkimet e mundshme ne mjedis te tilla si ujera te ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime si dhe per prodhimin e mbetjeve**

Uji do përdoret gjatë procesit të prerjes si dhe për lagjen e territorit për paksimin e pluhurave gjatë procesit të levizjes së automjeteve dhe do sigurohet përmes depozitave nga shoqëria.

Ujërat e shiut do të sistemohen përmes kanaleve perimetrike dhe me pas do të bashkohen kanalizimeve kulluese të zonës. Thëksojmë se këto ujërat nuk përmbajnë elemente kimike ndotës.

Zhurmat kryesisht do të krijohen nga sharrat dhe nga levizja e automjeteve. Burimet e zhurmave janë në sipërfaqe. Çdo burim përhap varet zhurmë. Fusha akustike që rezultojnë varet nga karakteristikat e absorbimit dhe reflektimit të të gjitha pengesave ekzistuese, ndërmjet burimit dhe receptorit.

Energjia zvogëlohet për gjatë rrugës si rezultat i absorbimit të sipërfaqeve, divergjencës gjeometrike dhe absorbimit atmosferik.

Programi i përdorur për llogaritjen e nivelit të zhurmave merr parasysh faktorin

“A” – niveli i presionit të zhurmës të llogaritur

Faktori « A » përbehet nga kontribuesit që vijojnë

Niveli i fuqisë së zhurmës në drejtim të përhapjes  $L_{ne\ drejtim\ te\ eres}$ , llogaritet për çdo burim

$$L_{ne\ drejtim\ te\ eres} = L_{W\_} - A$$

Niveli i zhurmave të këtyre automjeteve, është i atij niveli që nuk influencën si për të punësuarit dhe për banorët dhe gjallesat për rreth tij. Fenomene të tilla si vibracion zhvillimi i aktivitetit nuk do të ketë.

Mbetjet që krijohen do të jenë vetëm mbetje me karakter urban nga aktiviteti i përditshëm i punonjësve. Këto mbetje do të grumbullohen në kosha plastike dhe me pas do të depozitohen në vendin e caktuar nga bashkia.

- **Informacion për kohezgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar**

Gjatë fazës normale të zhvillimit të projektit nuk do të ketë emetime të gazeve, lëngjeve, mbetjeve toksike, helme të ndryshme dhe substanca të tjera të dëmshme, të cilat mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e punonjësve, banorëve dhe mjedisin përreth, floren dhe faunën e zonës, burimet ujore.

- **Te dhena per shtrirjen e mundshme hapesinore te ndikimit negativ ne mjedis, qe nenkupton distancen fizike nga vendodhja e projektit dhe velrat e ndikuara qe perfshihen ne te**

Duke njohur aktivitetin qe do te zhvillohet u identifikuan ndikimet e mundeshme negative ne çdo receptore - perberes te mjedisit .

**Identifikimi i ndikimeve** – Permes te cilit u percaktua nderveprimi mjedis-projekt , u identifikuan ndikimet e mundeshme gjate kesaj faze sipas receptoreve te mjedisit.

**Vleresimi i ndikimeve** – Ekspertet mjedisore te fushave te ndryshme bene perpjekje per matjen e gravitetit te ndikimeve . Vleresimi i Sinjifikances ka te beje me vete rendesine e ndikimeve dhe eshte faza me e rendesishme per zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe peraftron ate me objektivisht me teresine e bashkeveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e perdorur per vleresimin e rendesise se ndikimeve variojne dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit te ndikuar.

**Shtrirja fizike-** Vlereson siperfaqen apo dimesionin hapsinore te nje ndikimi te dhene ne raport me burimin qe gjeneron ate ndikim.

- **Kohezgjatja e ndikimit** – Vlereson se sa do te zgjase nje ndikim i caktuar ne dimesionin kohe (ndikim i perhershem apo i perkoshem).

-**Kthyeshmeria** –Vlereson mundesin e kthimit te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e tij te me pareshme (aftesia per tu rehabilituar dhe regjeneruar )

-**Rendesia** – Realizon nje vleresim total te tre permasave te mesiperme dhe njekohesisht thekson vemendjen qe duhet patur per administrimin e ndikimit.

Ndikimet e parashikuara nuk kane shtrirje te madhe fizike, zhvillimi i aktivitetit nuk ka ndikime negative ne zone. Zhurmat qe krijohen nga levizja e mjeteve qe do te sjellin dhe marrin guret dekorativ nuk perbejn ndotje akustike. Analiza e frekuences te zhurmes te emetuar nga keto mjete tregon se ato ndodhen nen mesataren e frekuences 100 – 150 Hz , e cila eshte e pranueshme nga veshi i njeriut . Koha ne te cilen do te jene te pranishme keto zhurma eshte vetem gjate furnizimit. Niveli i zhurmave te ketyre mjeteve ne largesi nuk do te jete i madh dhe do te jete konform normave ne fuqi.

Ne kushte normale te zhvillimit te aktivitetit nuk vleresohen ndikime te rendesishme te cilat mund te shkaktojne ndotje ne distance te medha.

- **Mundesine e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme si dhe kostot financiare te peraferta per rehabilitimin**

### **Qëllimi i planit të rehabilitimit**

Përgatitja dhe zbatimi i këtij plani rehabilitimi përgatitur në zbatim të kushteve të lejes mjedisore të veprimtarisë për të rehabilituar objektin ku është vendosur instalimi sipas kërkesave ligjore mjedisore duke riaftësuar sipërfaqen e ambientit të shfrytëzuar, nëse shoqëria **“NDERTIMI KRISTIAN”** për arsye të ndryshme do të mbyllë aktivitetin e saj të prerjes, gdhendjes dhe lustrimit të gurit, apo do të transferojë linjen e impiantit në një vendodhje tjetër.

### **Synimet e Planit të Rehabilitimit**

Plani i rehabilitimit synon që

- Të ketë realizuar stabilizimin fizik të objektit ku ndodhet instalimi.
- Të ketë realizuar punimet biologjike me qëllim mbrojtjen e mjedisit të zonës dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.
- Të ketë pastruar të gjithë sipërfaqen në shfrytëzim nga makinerite, instalimi dhe mbetjet e ndryshme, si dhe rikthimin e saj në gjendjen e mëparshme
- Të ketë mundur zhvillimin e proceseve natyrore të cilat dallohen qartë nëpërmjet indikatorëve abiotike dhe biologjike dhe evoluojnë me stadin e zhvillimit të riaftësimit

### **Hapja dhe mirëmbajtja e rrugës të brendshme automobilistike**

Shoqëria **“NDERTIMI KRISTIAN”**, është kujdesur për mirëmbajtjen e infrastrukturës së brendshme rrugore, nën administrimin e saj dhe që i shërben qëllimit kryesor të kësaj shoqërie. Subjekti ka sistemuar të gjithë sheshin në dispozicion duke shtruar një sipërfaqe me beton dhe pjesën tjetër me zhavorr.

### **Mirëmbajtja e kanaleve për dranazhim**

Me qëllim mbrojtjen nga përmytjet shoqëria realizon mirëmbajtjen dhe ben pastrim periodik të sistemit të drenazhimit të ujrave të shiut në territorin ku ndodhet linja e prerjes, gdhendjes dhe lustrimit të gurit.

Gjithashtu do të mirembahet dhe pastrohet periodikisht vaska e dekantimit të ujrave teknologjike që vijnë nga pastrimi i linjes së prodhimit dhe sperkatja e produkteve të përfutuara.

### **Mirëmbajtja e bimësisë**

Me qëllim përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe mbrojtjen e mjedisit nga ndotja, shoqëria kujdeset për mbarëvajtjen e bimësisë së zonës. Synimi i saj është shtimi i hapësirave të gjelbërta në territorin ku zhvillon aktivitetin e saj, rrethimi i objektit me kurorë pemësh autoktone duke harmonizuar objektin me vlerat biologjike të zonës.

- **Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis**

Me qëllim që të parandalohen, shmangien minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore të aktivitetit gjatë zhvillimit të tij, investitori duhet të marrë masat e duhura për mbrojtjen e mjedisit.

### **Masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve në ajër**

Gjatë fazës së operimit burimet nga të cilat shkaktohen dhe emetohen gaze dhe grimca të ngurta janë: lëvizja e automjeteve dhe proceset teknike të operimit. Për këto aktivitete kompania të zbatojë masat zbutëse e mëposhtme:

1. Lënda djegëse e cila do të përdoret nga mjetet dhe automjetet që do të operojnë gjatë fazës furnizimit dhe transportit të gureve dekorativ të jetë e një cilësie të mirë.
2. Mjetet dhe automjetet që do të përdoren do të jenë kryer serviset teknike e duhura.
3. Mjetet dhe automjete që do të përdoren nuk do të jenë të amortizuara të cilat mund të shkaktojnë emetime të gazeve në nivele të larta në atmosferë.
4. Të realizohet spërkatja e ambjenteve në mënyrë që të reduktohet sasia e pluhurit që mund të shkaktohet gjatë lëvizjes së automjeteve.
5. Ambjentet përreth të spërkatën me ujë për të shmangur pluhurin.

### **Masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve në tokë**

Në bazë të analizës së vlerësimit ndikimet në cilësinë e tokës do të hasen vetëm në rast se do të ketë shkakime aksidentale të hidrokarbureve të cilat ndikojnë në ndotjen e asaj sipërfaqeje. Madhësia e këtij ndikimi do të jetë në varësi të madhësisë së aksidentit. Kompania duhet të aplikojë masa për parandalimin e cdo aksidenti në mjedis.

- Kompania të përcaktojë një vend të caktuar dhe të pajisuar me kosha për grumbullimin e mbetjeve urbane.

-Gjatë perimetrisë së sipërfaqes ku do të operojë kompania të hapen kanale kulluese në mënyrë që të sistemohen ujërat sipërfaqësorë të shirave

Kompania operon më ndërgjegjësimit të lartë mjedisor. Kjo duket edhe nga ambjentet brenda territorit ku ajo operon janë të shtruara me beton, të pastra dhe asnjë lloj mbetje nuk është epërhapur në tokë. Ky lloj menaxhimi shmang edhe ndotjen e tokës.

### **Masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve në ujrat sipërfaqësorë**

Operimi i këtij lloji projekti nuk gjeneron ujra teknologjik te ndotur dhe për këtë arsye nuk ndikon në mënyrë të drejtë për drejtë në ujrata sipërfaqësorë.

-Të sistemojë ujrata sipërfaqësorë të sheshit në të cilin do të operojë.

#### **Masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve në biodiversitet**

- Subjekti në fazën e operimit të kryejë monitorim periodik të nivelit të zhurmave që gjenerohen, në mënyrë që ato të mos jenë shqetësuese për mjedisin natyror.

- Rrugët dytësore dhe të gjithë infrastruktura që do të përdorë subjekti për zbatimin e këtij projekti të spërkatën në mënyrë periodike për të ulur nivelin e përhapjes së grimcave të ngurta në atmosferë.

- Ndricimi i zonës ku do të zhvillohet projektin gjatë natës të projektohet në atë mënyrë që të mos jetë shqetësues për kafshët e egra.

#### **Masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve në peisazh**

Për zbutjen e ndikimeve nga prania e projektit në peisazhin natyror kompania të zbatojë këto masa gjatë fazës operimit:

- Përreth sheshit të mbillen pemë të larta

- Mjedis të mbahet i sistemuar dhe i pastër

- Të shmangen shkaktimi dhe përhapja e pluhurit në atmosferë

- Të shmangët grumbullimi i mbetjeve për një kohë të gjatë

Për të parandaluar dhe përballuar situata emergjence me personelin e shërbimit dhe të punonjës të kompanisë, janë programuar dhe zhvilluar tema stervitje, alarme dhe ushtrime në drejtim të ndergjegjesimit për zjarrin; të dallimit të objekteve dhe personave të dyshimte; të kercenimit me bombe apo pakot e dyshimta me synimin, që çdo punonjës i kompanisë si me dhe, pa detyra të veçanta sigurie të ndergjegjesohen me detyrat e sigurisë.

#### **Masat specifike për parandalimin e zjarrit**

Masat kryesore të mbrojtjes nga zjarri finalizohen me zvogëlim të probabilitetit të ndodhjes së një zjarri, ato individualizohen si më poshtë:

Realizimi I impianteve elektrike sipas te gjitha rregullave

Zjarret shkaktohen ne rreth 30% te rasteve nga perdorimi difektoz I lidhjeve elektrike, prandaj del e domosdoshme rendesia e marrjes se masave per pergatitjen dhe montimin e impianteve elektrike sipas te gjitha rregullave pasi keshtu behet e mundur qe te ulen ne menyre te ndjeshme shkaqet kryesore te zjarreve.

Lidhjen me tokezim tokesor te gjitha pajisjeve , impianteve.

Ventilim natyral dhe artificial te ambjenteve te mbyllura

Kompletimin me pajisjet anti zjarr

Sinjalistiken sigurorese sidomos referuar rreziqeve qe ekzistojne ne vendet e punes

Nga ana e shoqerise do te caktohet nje person per mbrojtjen nga zjarri I cili ben verifikimin e zbatimit te rregullave ne vendet e punes per ndjekjen e zbatimit te tyre. Punonjesit keshillohen qe para se te largohen nga vendi I punes apo ne perfundim te orarit te punes duhet te bej pastrimin dhe lenien e tij ne kondita te sigurta per mbrojtje nga zjarri. Kryhet kontroll periodik per mjetet e mbrojtjes ndaj zjarrit, sistemeve te alarmit dhe pajisjeve elektrike.

### **Kontroll operativ I gjendjes se fikesave dhe depozites se ujit**

Cdo fikese zjarri ne vendin e caktuar inspektohet cdo muaj . Gjate inspektimi vizual verifikohet :

- Fikese te jet I vendosur afer vendit potencialisht te rrezikshem
- Nuk duhet te jete I boshatisur
- Siguresa nuk duhet te jete e prekur ose e ndotur
- Shigjeta e presionit duhet te jete ne fushen e duhur
- Nuk duhet te kete demtime mekanike ose korrozioni ose zenie te duzes se gypit hedhes
- Vendi perreth fikses te jete I paster dhe pa pengesa
- Vendodhja te jete e dukshme
- Cdo konstatimi pa rregullt raportohet per marrjen e masave

### **Masa të tjera lehtësuese, për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës**

Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë dekorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.

Të shmanget në maksimum perdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.

Të kryhet lagia e sipërfaqeve të sheshit para objektit gjatë stinës së verës, pastrimi i vendit së depozitimit të lëndës së parë, si dhe të rrugëve komunikuese. Të kryhet rrethimi i objektit dhe linjës së prodhimit dhe të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjesit.

Të reduktohet qarkullimi në orët e pikut të trafikut, për të mos krijuar trafik të rënduar në zonë.

Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulët.

Të vendosen kontenier për mbajtjen pastër të ambjenteve nga mbetjet urbane për numrin e punonjësve.

Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM. .

Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij. Subjekti të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrëfikset.

Të kryhet monitorimi i indikatorëve të mjedisit sipas ligjeve në fuqi.

Si rezultat i realizimit të projektit nuk do të absorbohen ndikime të rëndësishme mjedisore, sociale në shëndetin e njerëzve.

Për pasoj ndikimet e parashikuara mund të minimizohen duke zbatuar masat e përmendura më sipër.

Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.

Është detyrë e Njesise Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.

Është detyrë e të gjithë kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshëm si gjatë fazës së prodhimit të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.

### **Masa lehtësuese të tjera të kërkuara**

Do të bëhet një menaxhim sa më me eficient të energjisë elektrike.

Implantet e nevojshme janë projektuar në përputhje me Ligjin e ri, Nr.9379, datë 28-04-2005 “Për Eficencën Energjisë”, kjo do të çojë në uljen e ndotjeve termike të mikroklimës së zonës si dhe kursim të energjisë elektrike nga përdorimi i makinerive/implantit me eficientë.

Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.

Subjekti të kryejë aktivitetin, vetëm brenda kordinatave të sipërfaqes së tokës që disponon në pronësi.

Do të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emëtimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari të mundshme teknike të mjeteve.

Shfrytëzimi do të bëhet në mënyrë të tillë që të shmangë në maksimum dëmtimin e burimeve ujore, devijim e rrymave ujore, erozionin dhe dëmtimin zonave përreth.



Do të instalohet sistem i ujitjes për mjedisin përreth (varet dhe nga hapësira e planifikuar për gjelbërim si dhe pozicioni që ato do të kenë) si dhe lagia me ujë e rrugicave të brëndshme gjatë periudhës Maj-Tetor.

Pajisjet , do të koluadohet në mënyrë periodike nga teknikë të specializuar dhe çertifikuar për të tilla procese.

Veglat e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe efencës që kanë në kryerjen e operacioneve prodhimit.

Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet në zonën e shfrytëzuar do të lyhet periodikisht me bojë higjenike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjeno-Sanitare.

Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë; lëndë të aballazheve, letra kartona, si dhe lëndë organike të prodhuara , ku këto mbetje do të transportohen rregullisht në vendin e caktuar nga Njesia Vendore, ku firma do të marrë masa për menaxhimin e këtyre mbetjeve të ngurta, do të vendosen në kosha selektive sipas rrymave specifike të mbetjeve.

Do të bëhet pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujit të shiut në këtë objekt ose e mjedisit përreth drejt mjediseve të gjelbëruara, një mundësi e mirë dhe për vaditje dhe shmangie të derdhjes së tyre në mjedis si dhe shmangie të përdorimit të ujit të pijshëm për vaditje.

Mjedis i gjelbëruar përreth do të jetë nën kujdesjen e personelit që do të punësohet vetëm për punimet agro-mjedimore të nevojshme.

Rrjeti elektrike është togëzuar për të shmangur ndonjë shkarkesë elektrike, konform kushteve teknike,

Zona ku do të zhvillohet aktiviteti është e rrethuar, me qëllim për të shmangur hyrjet e paautorizuara të individëve dhe faunës së zonës përreth. Janë ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme të mbrojtjes kundra zjarrit(per kete është hartuar dhe plani perkates).

Për të mbrojtur kundër zjarrit të mundshëm që mund të bjerë do të ruhen largësitë mbrojtëse ndaj zjarrit të objektit dhe linjës së prodhimit.

Aktiviteti disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksive, etj.

Eshtë ndertuar sistemi i drenazhimit te ujrave dhe lëvizjes së ujërave të shiut.

Lidhja në burimet e furnizimit me ujë, janë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat gjatë një viti, veçanërisht gjatë muajve të verës, kur normalisht kërkesa është më e lartë. Furnizimi me ujë sigurohet në një nivel të tillë presioni, në mënyrë që të jetë i mjaftueshëm për të shpërndarë sasinë e nevojshme të ujit në të gjithë gjatësinë e objektit dhe instalimit, por jo aq sa të demtojë pajisjet hidraulike (efekti i grushtit hidraulik) ose të krijojë rreziqe tek objekti apo aparaturat dhe jetën e punonjësit.

Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafi përgjegjës për operimin e punës në impiantin e prerjes.

### **Programi i monitorimit të mjedisit**

Qëllimi i monitorimit mjedisor është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performance mjedisore të zbatimit të projektit.

Monitorimi i mjedisit është detyrim ligjor, mënyra, frekuenca dhe elementët e monitorimit janë të ndryshëm për veprimtari të ndryshme. Në vijim do të paraqesim elementët që duhet të monitorojë subjekti gjatë funksionimit të instalimit. Elementët e tjerë apo përcaktimi i frekuencave të monitorimit do të përcaktohet në akt miratimin e lejes mjedisore për këtë veprimtari.